



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa
Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë të dispozitave të nenit 41 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J

Mbledhjen e pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa e cila do të mbahet më 19.07.2018 (e enjte) duke filluar në ora 10:00.

Rendi i ditës

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së;
2. Raporti i Kryetarit të Komunës për gjashtmuorin e parë Janar – qershor 2018;
3. Raporti i tremujorit të dytë Financiar Prill – Qershor 2018;
4. Raporti mbi përfundimin e vitit shkollor 2017/18;
5. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet në hapësirat e K.K-së në Novobërdë.

Më: 12.07.2018
Në: Novobërdë



Kryesues i Kuvendit
Nebojsa Arsic

(Signature)



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova

Komuna e Novobërdës

Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY


PROCESVERBAL

Nga mbledhja e katërtë e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 18.06.2018, duke filluar në orën 10:00. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Anëtarët e KPF-së: Nebojsa Arsic, Predrag Stojković, Xhejlane Behluli, Milica Jovanovic, Ramush Mehmeti, Drejtori i Financave Sercan Todorovic, Menaxheri i Prokurimit Fatos Ahmeti dhe përfaqësuesi i OSBE-së Edmond Hyseni.

Kryesuesi pasi përshëndeti të pranishmit tha: para se të fillojmë me punën e KPF-së dhe rendin e ditës duhet konstatuar kuorumin prezentë janë të gjithë antarët e KPF-së pas kësaj e hapi mbledhjen me këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së;
2. Shqyrtimi i propozim Kornizes Afatmesme Buxhetore 2019 – 2021;
3. Plani operativ i korjes për vitin 2018;
4. Të ndryshme.



Kryesuesi i njoftoi të pranishmit se para fillimit të mbledhjes ka kontaktuar me Kryetarin e Komunës dhe i ka propozuar tri pika shtesë për rend të ditës pasi që për arsye zyrtare nuk ka mundur të jetë prezent sot, pika e parë e propozuar është shqyrtimi i mundësisë për pruarjen e vendimit mbi shpronësimin e tokës për ndërtimin e rrugës jashtë vendbanimit Stanishor – Gllamë, pika e dytë është pruarja e një vendimi të shumës së mjeteve në lartësi prej 5000 € për sigurimin e lopëve për familjet e dëmtuara nga vjedhjet dhe pika e tretë pruarja e vendimit për dhënjën me qira të sallës së sporteve të shkollës ekonomike në fshatin Bostan.

Kryesuesi i pyeti të pranishmit a pajtohen me rend dite dhe me këto pika të propozuara apo keni ndonjë diskutim?

Ramush Mehmeti pasi përshëndeti të pranishmit tha: fatkeqësisht e katërta seancë e KPF-së shkon me shkelje të ligjit unë e kam marrë emailin me material të enjten kjo është shkelje e papranueshme pasi që ligji thotë shtatë ditë pune para seancës të KPF-së duhet të dëgohet materiali, e dyta me ligj lejohet që të ketë pika shtesë për 10% në rend të ditës por të ketë 50% pika shtesë kjo është e tepërt, por sa i përket këtyre pikave të propozuara mendoj se duhet të bëhet analizë më e thellë, ne e kemi formuar komisionin për dhënjë të tokës në shfrytëzim dhe duhet ditur se a është pronë Komunale apo pronë private, kur të mirret vendimi duhet ditur se për çfarë pronë po bëhet fjalë dhe në çfarë shume po paguhet qiraja, sa i përket pronës së shkollës nese e shfrytëzon ndonjë shoqatë duhet ditur a e ka marrë përmes Kuvendit në shfrytëzim, nese është objekti i shkollës me Ministri duhet të mirret pelqimi nga Ministria, ndërsa nese është objekti dhe toka e Komunës pajtohem por duhet ditur çmimi dhe për sa kohë do të shfrytëzohet ky objekt me qira, komisioni është të fillojë procedurat nese Komuna ka interes për dhënjë të këtij objekti me qira, ndërsa sa i përket ndarjes së shumës për blerje të lopëve pajtohem por duhet ditur se kujt po i ndihmojmë dhe mendoj që kjo temë duhet të diskutohet më shumë pasi që po ka shumë vjedhje të kafshëve pasi që ky problem nuk është vetëm të komuniteti serb por edhe të

komuniteti shqiptarë andaj pajtohem edhe unë që të ndahet një shumë buxhetore por duhet ditur se prej cilit kod buxhetor po ndahen mjetet dhe kush po përfiton nga këto mjete. Gjithashtu kam dëgjuar që po ndahen makina bujqësore po ne nuk e dim se kush ka përfituar dhe nuk e di se me çfarë procedura po ndahen, duhet të analizohen pasi që Komuna nuk është pronë private por institucion dhe duhet të ipet llogari për keqperdorime nese ka, andaj kërkoj që të zbatohet ligji, ju faleminderit.

Sinisa Markovic Zyrtar i Informimit pasi përshendeti të pranishmit tha: Kryetari më ka autorizuar që të ju informoj rreth këtyre pikav shtesë, pajtohem me atë që tha Ramush Mehmeti por Kryetari do ti autorizoj organet përgjegjëse të Komunës për secilen pikë veç e veç dhe ata do të pregadisnin materialin për mbledhje të Kuvendit, nese e pregadisnin materialin për Kuvendin e ardhshëmë vendosen edhe këto pika, ne tash po propozojm që ti aprovojm si pika shtesë dhe ti votojm që të shkojnë në Kuvend, nese kemi material i diskutojm në Kuvend, nese nuk ka material atëher nuk i diskutojm në Kuvend, nese nuk dihet se kush është pronar i asaj shkollës nuk mundë të vendosmi, mendoj që është mirë që ti përkrahni këto pika që të shkojnë në Kuvend dhe besoj që për mbledhje të Kuvendit do ta keni materialin për secilen pik.

Pasi nuk pat diskutime tjera u aprovua rendi i ditës me këto tre pika shtesë të propozuara nga Kryetari i Komunës:

1. Shqyrtimi i mundësisë për pruarjen e vendimit mbi shpronsimin e tokës për ndërtimin e rrugës jashtë vendbanimit Stanishor – Gllamë;
2. Pruarja e një vendimi e shumës së mjeteve në lartësi prej 5000 € për sigurimin e lopëve për familjet e dëmtuara nga vjedhjet;
3. Pruarja e vendimit për dhënjën me qira të sallës së sporteve të shkollës ekonomike në fshatin Bostan;

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së;

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Xhejlane Behluli pasi përshendeti të pranishmit tha: vetëm të përmirsoj D.SH.P Shefkije Mehmeti pasi që kompanin qe e ka cek nuk është Kompania Gazi por Kompania Gini që ka fituar tenderin ne Pasjak për mbledhje te mbeturinave.

Pasi nuk pat diskutime tjera kjo pikë u votua njëzëri nga të gjith antarët prezent.

Pika e dytë: Shqyrtimi i propozim Kornizes Afatmesme Buxhetore 2019 – 2021;

Për këtë pikë Kryesuesi ja dha fjalën Drejtorit të Financave Sercan Todorovic.

Sercan Todorovic pasi përshendeti të pranishmit tha: më material e keni marrë projektin për KAB 2019/21 është vetem propozim dhe mundë të bëjmë ndryshime, ky propozim i KAB aprovohet çdo vit, mbahen debate publike me qytetarët e Komunës dhe pas kësaj Kuvendi e bënë shqyrtimin dhe aprovimin dhe pastaj dërgohet në Ministri, kjo korniz buxhetore përgaditet në bashkpunim të ngushtë me Ministrin e Financave. Në faqe 6 janë të hyrat vetanake për periudhën kohore 2019/21 nga granti i përgjithshëm dhe të hyrat nga administrata Komonale janë të ndara për secilin vit, gjithashtu tju inforoj se këtë korniz buxhetore e kem përgaditë në bashkpunim të ngushtë me të gjitha drejtoritë, na faqe 15 është lista e projekteve kapitale të parapara për çdo vit, unë e prezantova shkurtimisht kornizen pasi e keni marrë më material nese keni ndonjë pyetje udhëroni dhe ju lus që ta përkrahni këtë pikë që të shkoj në Kuvend, ju faleminderit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Ramush Mehmeti pasi përshendeti të pranishmit tha: me keqardhje e them se nuk kam pasur shumë kohë për ta analizuar këtë korniz buxhetore, Drejtori na sqaroi se si shkon korniza deri në aprovim dhe e kisha pyet drejtorin se dëgjimet publike kush i organizon dhe në çfarë kohe dhe kush është kompetent dhe pyetja tjetër është të faqja 5 është e pakuptimtë që numri i banorëve për çdo vit të jetë i njëjtë, gjithashtu edhe të numri i bizneseve është i njëjtë për çdo vit dhe të planifikimi i të hyrave vetanake është e përcjell e njëjta shumë për çdo vit, p.sh të të hyrat e tatimit në pron për çdo vit është shuma e njëjtë ne asnjë vitë nuk ka rritje apo zbritje dhe për mu është jo serioze që kjo korniz të dërgohet në Kuvend pasi që logjikisht nuk mundët të jenë të hyrat njëjtë për çdo vit, ndërsa sa i përket listës së projekteve kapitale është caktu shuma të asfaltimi i rrugëve por nuk është cekur se cilat rrugë do të asfaltohen, ju faleminderit.

Sercan Todorovis tha: e permenda në fillim se është vetem propozim korniz, sot prej orës 12:00 e kemi një takim me qytetarë, ndërsa buxheti aprovohet në shtator ne organizojm takime me qytetarë si Drejtori e

Financave ku merr pjesë edhe Kryetari i Komunës në takime i dëgjojmë kërkesat nga qytetarët dhe i marrim propozimet e tyre ne nuk mundë të bëjmë ndryshime në paga dhe mallra e shërbime por në investime kapitale mundë të ndryshojmë në bazë të kërkesave që i kan qytetarët dhe i bëjmë edhe projektet.

Ramush Mehmeti tha: e di se është propozim por të thuhet se në këtë propozim se tatimi në pronë për çdo vitë të jetë i njëjte nuk është serioz ose të regjistrimi i automjeteve të jetë i njëjte është e pamundur ose duhet të ketë rritje, por duhet të ketë ndryshim duhet të planifikohet rritje pasi që nuk është e mundur që për çdo vit të jetë i njëjtë, gjithashtu mendoj se duhet të analizohet mirë ligji për Financat Publike, pasi që KPF është kompetent me organizu debate publike ne bashkpunim me Kryetarin.

Sercan Todorovic tha: harrova ta cekë se edhe Kryesuesi i Kuvendit është obligativ që të organizoj një debat publik me qytetarët dhe antarët e Kuvendit.

Predrag Stojkovic pasi përshëndeti të pranishmit tha: edhe ne statut ceket se KPF duhet ta shqyrtoj buxhetin dhe së paku në një debat publik të merr pjesë.

Ramush Mehmeti tha: ju Kryesues e keni stafin e Kuvendit dhe antarët e Kuvendit duhet të njoftohen paraprakisht për debate publike, gjithashtu do të organizohet vita e punës për KAB por unë si antarë i Kuvendit zyrtarisht nuk jam i njoftuar dhe ne duhet të pregaditemi paraprakisht dhe të kërkojm leje prej punës pasi që ne punojmë, unë dëgjova prej qytetarëve që sot mbahet debat publik.

Sercan Todorovic tha: pasi që veç keni dëgjuar nga qytetarët do të thotë që qytetarët janë të njoftuar, ne gjithashtu kemi vendosur shpallje në çdo vendbanim dhe është debat me qytetarë dhe jo me antarë të Kuvendit.

Kryesuesi tha: nese nuk ka diskutime tjera e kalojmë ne votim që këtë pikë ta dergojm në Kuvend.

Pasi nuk pat diskutime tjera kjo pikë u votua me 4 vota për 1 kundër (Ramush Mehmeti) që të shkoj në Kuvend.

Pika e tretë: Plani operativ i korjes për vitin 2018;

Për këtë pikë Kryesuesi ja dha fjalën Drejtorit të Financave Sercan Todorovic.

Sercan Todorovic tha: fillimisht kërkoj falje në emër të Drejtoris së Bujqësisë pasi që kan pasur obligim që të shkojnë në Ministri të Bujqësisë të diskutojn pikërisht për këtë plan dhe për mbledhje të Kuvendit do tju dërgojm materialin.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pat diskutime kjo pikë u votua njëzëri nga të gjith antarët prezent.

Pika e katërtë: Të ndryshme;

Kryesuesi tha: duke e pasur parasysh se ne mbledhje të kaluar keni kërkuar një raport për realizim të projekteve prej zyrës së prokurimit unë e kam ftuar Menaxherin e prokurimit për ta prezantuar raportin.

Ramush Mehmeti tha: unë në senac të KPF kam folur për kompetencat e KPF dhe ne mbledhje kam cek se zyrja e prokurimit është obligative të prezantoj planin e punës për vitin kalendarik dhe në fund për të arriturat, jo për dëshirë të një antari të komitetit por në bazë të ligjit për vetqeverisje lokale dhe ne duhet të dim a janë shpall tenderet, a janë zotu mjetet a ka vështërsi dhe deri ku kan arritur procedurat. Mundë të na raportoj me goj por pikë e rendit të ditës nuk është fut dhe duhet të jetë pikë e veçant ku thuhet se KPF shqyrtoj raportin e zyrës së Prokurimit e njëjta gjë vlen edhe për zyren e auditimit e cila duhet të raportoj edhe ne Kuvend.

Fatos Ahmeti pasi përshëndeti të pranishmit tha: te ju informoj se në bazë të ligjeve në fuqi zyra e prokurimit i raporton vetem Kryetarit të Komunës në çdo gjashtmuorësh dhe raporti i zyrës së prokurimit është i përbashkët me raportin e Kryetarit të Komunës ndërsa sa i përket kërkesës tuaj çdo gjë është në rregull.

Planifikimi i Prokurimit bëhet në bazë të buxhetit 30 ditë para fillimit të vitit fiskal, ky palnifikim pregaditet duke bashkpunuar ngusht me njësitë kërkuese, planifikimi përfundimtar dërzohet ne Agjensionin Qendror të Prokurimit 15 ditë pas aporvimit të buxhetit në Kuvendin e Kosovës, deri më datë 16.04.2018 me hyrjen ne fuqi të rregullores së re planifikimi i prokurimit ka qenë konfidencial, planifikimi i prokurimit për vitin 2019 do të bëhet publik si në web faqe të Komunës dhe në platform elektronike të prokurimit, një planifikim i mirë është i lehtë për tu realizuar dhe vazhduar procedurat por kemi vështërsi të madhe te mallrat dhe shërbimet për ti planifikuar ndërsa te projektet kapitale është lista e projekteve dhe nuk po ka vështërsi, për këtë vit janë të palnifikuara në mallra dhe shërbime rreth 8.000€, shpenzime për mirëmbajtje pastrimi jan planifikuar rreth

6.000€, furnizimi për stamatologji janë planifikuar rreth 5.000€, furnizim për lëndë djegëse (dru dhe karburante) janë planifikuar rreth 70.000€, furnizim me paisje të IT janë planifikuar rreth 9.000€, kontrata për shërbime rreth 55.000€, kapitale rreth 700.000€, pritoritet jemi duke ju dhënë granteve qeveritare, gjithashtu tju njoftoj se tash me vendim të Ministrisë së Financave është autorizuar AQP që disa prej prokurimeve të bënë për të gjitha Komunitetet e Kosovës si p.sh furnizimi me naft, mendoj se projektet janë duke u realizuar mirë nëse keni ndonjë pyetje jam i hapur për diskutim ju faleminderit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë temë.

Xhejlane Behluli tha: e përgëzoj Fatosin për sqarimet dhe informatat e ofruara, unë nuk po e di këto kërkesa që bihen në KPF a dërgohen apo jo në Kuvend.

Fatos Ahmeti tha: obligativ duhet të raportoj vetëm Kryetarit të komunës, në raportin e Kryetarit të Komunës bashkangjitet edhe raporti i zyrës së prokurimit i detajuar me projekte dhe me vlera të kontratës por me kërkesë të Kuvend do të raportoj edhe në Kuvend.

Predrag Stojkovic tha: në Ligjin për Vetqeverisje Lokale thuhet se kujt duhet të raportohet dhe si shkojnë procedurat, e di se Kryetari bashkëpunon me zyrtarët financiar dhe iniciuesit e projekteve.

Ramush Mehmeti tha: nëse e shikojmë Ligjin për Vetqeverisje Lokale e gjejmë nënën ku thotë se KPF e shqyrton raportin e zyrës së prokurimit, e kam një pyetje se çka është problemi me shendetësinë pasi që është në një gjendje tmerruese.

Fatos Ahmeti tha: zyra e prokurimit vepron dhe punon në bazë të kërkesave të njësive kërkuuese, në momentin që ka kërkesa për me fillu me procedurën të ndonjë aktiviteti të prokurimit në fillojmë.

Kryesuesi tha: të ju informoj se MAPL ka kthyer përgjigje të vendimit nga mbledhja e kaluar që kemi aprovuar për shpallje të ish fabrikës së radiatorëve si objekt i rëndësishëm së veçant për Komunitetin e Novobërdës i cili është në pajtim me ligjin ndarsa tash i mbetet Kryetarit të fillojë procedurën, në një nga mbledhjet e ardhshme do të mund ta bëjmë të njëjtën gjë edhe për kooperativën bujqësore në Stanishor ku aty bëhen dy shërbime si shërbimet e shendetësisë dhe të ofiqarisë.

Predrag Stojkovic tha: në vendimin e kemi marrë i cili është në pajtim me ligjin tash vetëm duhet të fillojë procedurat me Agjensionin Kosovë të Privatizimit.


Kryesuesi tha: tju informoj edhe se e kemi shqyrtuar statutin e Komunës dhe kemi vërejtur se disa pika tash nuk janë në përputhje me ligjet e aprovuar prej vitit 2010, andaj duhet që të plotësohet, përpunohet dhe ndryshohet statuti i Komunës, në kohën më të shkrutë të mundshme do të formojmë një komision për plotësim dhe ndryshim të statutit Komunal që të përputhet me ligjet në fuqi, gjithashtu shpresoj se edhe OSBE-ja do të na ndihmojë në këtë drejtim.

Pasi nuk pati diskutime Kryesuesi i falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00

Procesëmbajtëse


Valmire Mustafa



Kryesues i Kuvendit

Nebojsa Arsic





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E NOVOBËRDËS - OPŠTINA NOVIBRDO
DALLËSE - IZLAZNA

NR/BI: 05-340

Marrë më: 12.07.2018

NOVIBRDO - NOVIBRDO



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



RAPORTI FINANCIAR

TË HYRAVE DHE TË DALURAVE PËR PERIUDHËN

PRILL - QERSHOR - 2018

KORRIK - 2018

Shfrytezimi I te hyrave dh te dalurave te shfrytezueseve buxhetor per periudhen Prill - Qershor 2018

Per te pasur nje pasqyr te shfrytezuesve buxhetor po ju paraqesim raportin e shpenzimeve te planifikuara dhe te realizuara per periudhen Prill - Qershor 2018

Nr	Shfrytezuesi Buxhetit	Kodi	Kodi I Drejtoris
1	Zyra e Kryetarit		16030
2	Administrata		16330
3	Zyra per komunikim		16490
4	Zyra per barayt gjinore		16530
5	Zyra e kuvendit komunal		16930
6	Buxhet dhe financa		17530
7	Inspekcioni		16659
8	Sherbimet publike - mbrojtja civile		18190
9	Zyra per komunitete		19650
10	Bujqesi, pylltari dhe zhvill. rur.		47030
11	Zhvillim ekonomik		48030
12	Urbanizem		66455
13	Shendetesi dhe mbrojtje prim. Shend.		74800
14	Sherbimet sociale		75645
15	Kultur rini dhe sport		85030
16	Administrata arsimit		92150
17	Arsim I mesem		95070
18	Arsim fillor		93870
19	Arsimi parashkollor kopshet		92790

Inkasimi eshte bere ne baze te Rregullores mbi taksat, ngarkesat dhe kamatat si dhe Rregullores per tatimin ne pro

Per tre mujorin e dyte 2018 kemi keto te hyra:

Te hyra vetanake per maujit Prill, Maj, Qershor

40110	Te hyrat nga tatimi ne pron	20,933.72
50001	Te hyrat nga regj. l automjeteve	2,805.00
50009	Taksa komunale per leje te ndertimit	3,487.89
50011	Taksa komunale per regjistrimin e trashgeg.	370.00
50012	Taksa per ndrrimin e destinationit te tokes	7,138.00
50013	Taksa per qertifikatat e lindjes	680.00
50014	Taksa per qertifikatat e kunorezimit	109.00
50015	Taksa per qertifikata te vdjekes	90.00
50019	Taksa tjera administrative	517.11
50019	Taksa per vertetimet prej 1€	263.00
50019	Taksa tjera administrative - lista poseduse	3,118.00
50408	Qiraja nga objektet publike	900.00
50405	Qiraja nga prona publike	1,270.00
50409	Participimi ne shendetesi	211.50
	Gjithsejt	41,893.22

MIJETET E SHPENZUARA Shtylyezuesit sipas njesive buxhetore

N.r	Shtylyezuesi i buxhetit	Paga dhe medije		malla dhe sherbime	shpenz. komune	Subvencione	Investi. Kapitale
		te planifikuara	te shpenzuara	te shpenzuara	te shpenzuara	te shpenzuara	te shpenzuara
1	Zyra e Kryetarit	€17,389.50	€14,616.21	€23,524.04	€14,626.00	€3,666.00	
2	Administrata	€41,683.50	€40,619.94	€4,340.88			
3	Zyra per komunikim	€1,332.50	€1,278.60				
4	Zyra per barazim gjinore	€18,750.00	€17,875.89	€1,610.19			
5	Zyra e kuvendit komunal	€11,692.25	€11,561.13				
6	Buxhet dhe financa	€8,371.75	€7,034.67				
7	Inspekcioni	€18,667.50	€17,186.94	€6,550.36			
8	Sherbimet publike - mbrojtja civile	€7,807.25	€7,725.84				
9	Zyra per komunitete	€11,454.00	€11,018.91				€4,997.00
10	Bujqesi, pylltari dhe zhvillim rural	€7,206.50	€5,876.43				€32,636.81
11	Zhvillim ekonomik	€10,749.50	€58,337.13		€5,617.00		
12	Urbanizem	€58,829.00	€5,993.91				
13	Shendetesi dhe mbrojtja prim. Shend.	€9,361.00	€10,161.93		€1,264.00		
14	Sherbimet sociale	€9,547.50	€8,871.63				
15	Kultur rini dhe sport	€47,040.25	€48,086.96	€6,638.73			
16	Administrata arsimit	€181,112.75	€180,882.94	€12,951.31			
17	Arsim i mesem	€3,275.00	€3,123.09				
18	Arsim filior						
19	Arsimi parashkollor kopshet						
	Gjithsej	€472,360.50	€460,136.64	€55,615.51	€21,507.00	€3,666.00	€37,633.81

Mijetet e planifikuara per tremujorin e dyte 2018 per paga dhe medije kane gene ne vler prej 472,360.50 Eu Kurse te shpenzuara jane ne vler prej 460,073.64 Eu. Ne pergjande jane 97.39 %.

Per mallra dhe sherbime jane shpenzuar ne vler prej 55,615.51 Eu.
 Per shpenzime komunele jane shpenzuar mjete me vler prej 21,507.00 E
 Per subvencione jane shpenzuar mjete ne vler prej 3,666.00 Eu.
 Per investime kapitale jane shpenzuar ne vler prej 37,633.81 Eu.

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Prill-Qershor-2018

Gjithsej	14,616.21	84.05 %
Per Paga dhe Medijte ka ne qene te planifikuar ne vler prej 17,389.50 Eu kurse te shpenzuar jane ne vler prej 14,616.21 Eu. Ne pergjande jane 84.05 %		
Per mallra dhe sherbime jane shpenzuar ne vler prej 23,524.04 Eu.		
Per Subvencione jane shpenzuar ne vler prej 3,666.00 Eu.		

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per peridhën Prill-Qershor- 2018

Gjithsej	40.619,94	Eu	Ne përqindje	97,44	%
Per Paga dhe Medije kane qene te planifikuar ne vler prej 41.683,50 Eu kurse te shpenzuara jane ne vler prej	40.619,94	Eu	Ne përqindje	97,44	%
Per mallra dhe shërbime jane shpenzuar ne vler prej 4.340,88 Evra					
Per mallra dhe shërbime jane shpenzuar ne vler prej 14.626,00 eu					
Per shpenzime komunalte jane shpenzuar ne vler prej					

ZYRA PER KOMUNIKIM 16490

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Prill-Qershor- 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall dhe sherb.	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Prill	€426.20			
2	Paga	Maj	€426.20			
3	Paga	Qershor	€426.20			
	Gjithsej		€1,278.60			€1,278.60

Per Paga dhe Medite kane gene te planifikuara ne vler prej 1,332.50 Eu kurse te shpenzuara jane ne vler prej 1,278.60Eu Ne perqindje jane 95.95 %

ZYRA PER BARAZI GJINORE 16530

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Prill-Qershor- 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall dhe sherb.	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Prill	€593.94			
2	Paga	Maj	€593.94			
3	Paga	Qershor	€593.94			
	Gjithsej		€1,781.82			€1,781.82

Per Paga dhe Medite kane gene te planifikuara ne vler prej 1,837.50 Eu kurse te shpenzuara jane ne vler prej 1,781.82 Eu Ne perqindje jane 96.96 %

ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL 16930

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Prill-Qershor- 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall dhe sherb.	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Prill	€5,941.13	Ushqim dhe pije	€162.50	
2	Paga	Maj	€6,151.13	Furniz. Me mat. Te zyr	€191.69	
3	Paga	Qershor	€5,783.63	Shpenzimet e telefonit	€115.00	
	Gjithsej		€17,875.89		€1,610.19	€19,486.08

Per Paga dhe Medite kane gene te planifikuara ne vler prej 18,750.00 Eu kurse te shpenzuara jane ne vler prej 17,875.89 Eu Ne perqindje jane 95.33 %.

Per mallra dhe sherbime jane shpenzuar ne vler prej 1,610.19 Evra

BUXHETI DHE FINANCA 17630

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Prill-Qershor- 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall dhe sherb.	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Prill	€3,853.71			
2	Paga	Maj	€3,853.71			
3	Paga	Qershor	€3,853.71			
	Gjithsej		€11,561.13			€11,561.13

Per Paga dhe Medite kane gene te planifikuara ne vler prej 11,692.25 Eu kurse te shpenzuara jane ne vler prej 11,565.70 Eu. Ne perqindje jane 98.87 %.

INSPEKSIONI 16659

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Prill-Qershor- 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall dhe sherb.	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Prill	€2,344.89			
2	Paga	Maj	€2,344.89			
3	Paga	Qershor	€2,344.89			
	Gjithsej		€7,034.67			€7,034.67

Per Paga dhe Medite kane qene te planifikuara ne vler prej 8,371.75 Eu kurse te shpenzuara jane ne vler prej 7,034.67 Eu. Ne pergjinde jane 84.00 %.

SHERBIME PUBLIKE 18190

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Prill-Qershor- 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall dhe sherb.	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Prill	€5,728.98	Shpenzimet e tjera	€2,445.00	
2	Paga	Maj	€5,728.98	Shpenz. E internetit	€520.00	
3	Paga	Qershor	€5,728.98	Shpenz. Te pagave	€1,745.16	
				Furniz. Per zyre	€1,043.70	
				ushqim dhe pije	€194.50	
				Dreka	€62.00	
				Shpenz. E telefonit	€540.00	
	Gjithsej		€17,186.94		€6,550.36	€23,737.30

Per Paga dhe Medite kane qene te planifikuara ne vler prej 18,667.50 Eu kurse te shpenzuara jane ne vler prej 17,186.94 Eu. Ne pergjinde jane 92.06 %.

Per mallra dhe sherime jane shpenzuar ne vler prej 6,550.36 Evra

ZYRA PER KOMUNITETE 19650

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Prill-Qershor- 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall dhe sherb.	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Prill	€2,575.28			
2	Paga	Maj	€2,575.28			
3	Paga	Qershor	€2,575.28			
	Gjithsej		€7,725.84			€7,725.84

Per Paga dhe Medite kane qene te planifikuara ne vler prej 7,807.25 Eu kurse te shpenzuara jane ne vler prej 7,725.84 Eu. Ne pergjinde jane 98.95 %.

BUQESI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL 47030

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Prill-Qershor- 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Invest. Kapitale	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Prill	€3,672.97	Furniz. me ma bujqesore	€4,997.00	
2	Paga	Maj	€3,672.97			
3	Paga	Qershor	€3,672.97			
	Gjithsej		€11,018.91		€4,997.00	€16,015.91

Per Paga dhe Medite kane qene te planifikuara ne vler prej 11,454.00 Eu kurse te shpenzuara jane ne vler prej 11,018.91 Eu. Ne pergjinde jane 96.20%.

Per investime kapitale jane shpenzuar ne vler 4,997.00 Eu.

ZHVILLIM EKONOMIK 48030

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Prill-Qershor- 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall dhe sherb.	Vlera	Kap. Invest.	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Prill	€1,958.81			Marten Per ndertim	€21,154.01	
2	Paga	Maj	€1,958.81			Permb. privat	€11,209.80	
3	Paga	Qershor	€1,958.81					
	Gjithsej		€5,876.43				32,363.81	€38,240.24

Per Paga dhe Medite kane qene te planifikuara ne vler prej 7,206.50 Eu kurse te shpenzuara jane ne vler prej 5,876.43 Eu. Ne pergjinde jane 81.54 %.

Per investime kapitale jane shpenzuar ne vler prej 32,363.81 Eu.

URBANIZEM 66455

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Prill-Qershor- 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall dhe sherb.	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Prill	€2,700.89			
2	Paga	Maj	€2,700.89			
3	Paga	Qershor	€2,700.89			
	Gjithsej		€8,102.67			€8,102.67

Per Paga dhe Medite kane qene te planifikuara ne vler prej 10,749.50 Eu kurse te shpenzuara jane ne vler prej 8,102.67 Eu. Ne pergjinde jane 75.37 %.

MIREQENIE DHE SHENDETESIA PRIMARE

74800

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Prill-Qershor- 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall dhe sherb.	Vlera	shpenz. komun.	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Prill	€19,407.65			myma	€5,617.00	
2	Paga	Maj	€19,407.65					
3	Paga	Qershor	€19,521.83					
	Gjithsej		€58,337.13				€5,617.00	€63,954.13

Per Paga dhe Medite kane qene te planifikuara ne vler prej 58,829.00 Eu kurse te shpenzuara jane ne vler prej 58,337.13 Eu. Ne pergjinde jane 99.16 %.

Per shpenzime komunale jane shpenzuar ne vler prej 5,617.00 Eu.

SHERBIME SOCIALE 75646

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Prill-Qershor- 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall dhe sherb.	Vlera	shpenz. komun.	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Prill	€1,997.97					
2	Paga	Maj	€1,997.97					
3	Paga	Qershor	€1,997.97					
	Gjithsej		€5,993.91					5,993.91

Per Paga dhe Medite kane qene te planifikuara ne vler prej 6,253.25 Eu kurse te shpenzuara jane ne vler prej 5,993.91 Eu. Ne pergjinde jane 95.85 %.

KULTUR RINI DHE SPORT 85030

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Prill-Qershor- 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall dhe sherb.	Vlera	shpenz.kommun.	Vlera
1	Paga	Prill	€3,392.94				
2	Paga	Maj	€3,387.31			ryma	€ 1,264.00
3	Paga	Qershor	€3,387.31				
	Gjithsej		€10,167.56				€ 1,264.00

Per Paga dhe Medite kane gene te planifikuara ne vler prej 9,361.00 Eu kurse te shpenzuara jane ne vler prej 10,167.56 Eu. Ne pergjinde jane 108.00%.

Per shpenzime komunale jane shpenzuar ne vler prej 1,264.00 Eu

ADMINISTRATA NE ARSIM 92150

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Prill-Qershor- 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall dhe sherb.	Vlera	shpenz.kommun.	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Prill	€2,957.21					
2	Paga	Maj	€2,957.21					
3	Paga	Qershor	€2,957.21					
	Gjithsej		€ 8,871.63					8,871.63

Per Paga dhe Medite kane gene te planifikuara ne vler prej 9,547.00 Eu kurse te shpenzuara jane ne vler prej 8,871.63 Eu. Ne pergjinde jane 92.92 %.

ARSIMI I MESEM 95070

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Prill-Qershor- 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall dhe sherb.	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Prill	€16,032.51	Ushqim dhe pije	€ 199.33	
2	Paga	Maj	€16,021.94	shpenz. tje. Te kontra.	€ 930.00	
3	Paga	Qershor	€16,032.51	Furnizimi me ore	€ 1,520.00	
				Furniz. me dru per dreg.	€ 3,989.40	
	Gjithsej		€48,086.96		€ 6,638.73	€ 54,725.69

Per Paga dhe Medite kane gene te planifikuara ne vler prej 47,040.25 Eu kurse te shpenzuara jane ne vler prej 48,086.96 Eu. Ne pergjinde jane 102.22 %.

ARSIMI FILLOR 93870

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Prill-Qershor- 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mali dhe sherb.	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Prill	€60.375.01	furniz. Me mat. Per 2yr	€ 1.001.19	
2	Paga	Maj	€60.265.60	Ostali ugov troskovi	€ 738.95	
3	Paga	Qershor	€60.242.33	Furniz. Me preg. sport.	€ 480.00	
				Furniz. Me ore	€ 1.538.00	
				Ushqim dhe pije	€ 54.00	
				Shpenz. E transportit	€ 7.095.15	
				Shpenz. E internetit	€ 84.00	
				Derivel	€ 1.960.02	
	Gjithsej		€ 180.882.94		€ 12.951.31	€ 193.834.25

Per Paga dhe Medite kane qene te planifikuara ne vler prej 181.112.75 Eu kurse te shpenzuara jane ne vler prej 180.882.94 Eu. Ne perqindje jane 99.87%.

Per malita dhe sherbime jane shpenzuar ne vler prej 14.580.33 Eu.

ARSIMI PARASHKOLLOR DHE CERDHE

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Prill-Qershor- 2018

Nr.	Lloji i shpenzimeve	muaji	Paga	Gjithsej
1	Paga	Prill	€ 1.041.03	
2	Paga	Maj	€ 1.041.03	
3	Paga	Qershor	€ 1.041.03	
	Gjithsej		€ 3.123.09	3.123.09

Per Paga dhe Medite kane qene te planifikuara njete ne shume prej 3.275.00 Eu. Kurse te shpenzuara jane 3.123.09 Eu. Ne perqindje 95.30 %.



vula:

Z. Svetislav Ivanovic
Drejtoreshi i Komunes

Z. Svetislav Ivanovic
Kryetar i Komunes

vula: